



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJSH

MUAJI QERSHOR



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

“Karakteristika të muajit Qershor dhe Stinës së Verës”



Çfarë duhet të dimë për Qershorin dhe Stinën e Verës?

- * Stina e verës është stina më e ngrohtë e vitit, ditët janë me diell dhe qielli është i kthjellët.
- * Vera ka tre muaj: Qershorin, Korrikun dhe Gushtin.
- * Në verë dita është më e gjatë se nata, dielli del herët dhe rrezet e tij përkedhelin gjithçka.
- * Në verë mbrëmja vjen më ngadalë dhe ne shikojmë hënën dhe qiellin të mbushur plot me yje, xixëllonja etj.
- * Lulet shkëlqejnë kudo dhe fluturat i lënë vendin bletëve për të mbledhur nektarin.
- * Kur vjen vera fëmijët ndjehen më të gëzuar, sepse shijojnë pishinat, detin dhe lojërat buzë tij, shëtitjet, akulloret dhe lëngjet e freskëta.
- * Qershori është muaji i parë dhe nis me një ditë të rëndësishme për fëmijët **1 Qershorin**.
- * Në Qershor ne shijojmë frutat dhe perimet e stinës.

Tema e Muajit: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës

Grupi: 24-36 muaj

- * **Java I:** Festa e 1 Qershorit. Njohja me karakteristikat e stinës së verës.
- * **Java II:** Frutat dhe perimet e stinës.
- * **Java III:** Përsërisim ngjyrat dhe numrat përmes veshjeve të stinës së verës.
- * **Java IV:** Format e argëtimit

Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës & Festa e 1 Qershorit




Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Festa e 1 Qershorit dhe karakteristikat e stinës së verës	Programi festiv. Njohja me disa nga karakteristikat kryesore të stinës së verës.	Java I
Frutat dhe perimet e stinës së verës	Njohja me frutat dhe perimet tipike të stinës.	Java II
Ngjyrat dhe numrat tek veshjet e fëmijëve në verë	Njohja me veshjet karakteristike të fëmijëve për verën, dhe ngjyrat e tyre. Numërimi përmes veshjeve.	Java III
Sa gëzim erdhi vera!!!	Format e argëtimit.	Java IV

Shënim:

- * Stafi edukator duhet të zhvillojë bashkë me fëmijët programin për **Festën e 1 Qershorit** në bazë të përgatitjeve që duhet të jenë kryer në muajin Maj.
- * Stafi edukator duhet nisë realizimin e mokitit të **Stinën e Verës** në çerdhe.

Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës
Tema e javës I: Festa e 1 Qershorit dhe karakteristikat e stinës së verës






Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë		<p>Aktiviteti festiv: Fëmijët në drejtimin e edukatoreve realizojnë programin festiv në grupe/çerdhe duke iu referuar këngëve, vjershave të mësuara gjatë muajit të kaluar.</p> <p>Vjersha dhe këngë të realizuara sipas programit vjetor me materiale të përzgjedhura.</p>	Manuali i Vjershave/Lojrave Përrallat e programit
E Martë	<p>Karakteristikat e Stinës së Verës</p>  <p align="center">Dielli</p>	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/bisedon me fëmijët për stinën e verës. Dita është më e gjatë se nata. Dielli lind më shpejt dhe ngroh më shumë etj.</p> <p>Shëtitje & Lojra energjike: Lojrat zhvillohen në oborr. (në ambiente të hapura)</p> <p>Punë dore: “Dielli” Përgatitja e Diellit me kartona/ letra me ngjyra. Në rrezet e tij të shkruhen emrat e fëmijëve ose vendosen fotot e tyre.</p> <p>Vjersha: “Dielli”</p>	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: kartonë, letra me ngjyra, lapsa.
E Mërkurë	<p>Qielli, yjet dhe hëna</p> 	<p>Aktiviteti 1: Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve se në verë, qielli është i pastër dhe i kthjellët. (Oborr/dritare)</p> <p>Aktiviteti 2: Netëve të verës hëna dhe yjet duken më qartë. A i keni parë yjet dhe hënën në qiell? (Përdoren ilustrime dhe figura me ngjyra)</p>	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike

		<p>Punë dore: “Hëna dhe yjet”- Krijimi i tyre përmes formave gjeometrike.</p> <p>Vjersha: “Ylli i vogël”</p>	
E Enjte	<p>Ngjyrat në natyrë</p> 	<p>Bisedë : Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve për ngjyrat në verë: Deti, qielli është blu/Rrezet e diellit janë të verdha/Bari, pemët të gjelbërta/ Lulet të kuqe, rozë, të verdha, të bardha, etj.</p> <p>Aktiviteti 1 : “Bëjmë kurora me lule shumëngjyrëshe”- në oborr. Edukatorja thekson ngjyrat e luleve dhe fton fëmijët të emërtojnë ngjyrat e luleve.</p> <p>Punë dore: “Ngjyrosim lulet” Edukatorët parapërgatisin modele lulesh. Fëmijët ngjyrosin lulet duke i zgjedhur vetë ngjyrat.</p> <p>Vjersha: “Dielli”</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete didaktike: fletë A4, lapsa me ngjyra.</p>
E Premte	<p>Zogjtë, pulëbardhat, mjellmat</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve rreth këtyre zogjve. Për ngjyrën e tyre të bardhë dhe për puplat, ku mund t'i shikojmë ato.</p> <p>Aktivitet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. “Me rërë dhe ujë”-në oborr. Improvizimi i detit/liqenit në një vaskë me ujë me varka letre brenda (varka me letra me ngjyra). 2. “Rrahim krahët si zogjtë”- edukatorët orientojnë fëmijët të lëvizin krahët si zogjtë. <p>Punë dore: “Pulëbardha dhe mjellma” Edukatorët parapërgatisin format me format A4 të bardhë. Prerja-ngjitja të kryhet bashkë me fëmijët.</p>	<p>Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: letra me të bardha, ngjitëse</p>


Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës

Tema e javës II: Frutat & Perimet e Stinës





Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Frutat e stinës së verës</p>  <p>Qershia</p>	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve/demonstron përmes formave, tabelës së lotos, revistave, frutat e stinës. Cilin prej frutave pëlqeni më shumë? A i pëlqeni qershitë? A i keni vendosur ndonjëherë tek veshi?</p> <p>Vizatim/Ngjyrosje: “Qershia”</p> <p>Vjersha: “Qershia”</p> <p>Përralla: “Kësulëkuqja”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete didaktike: fletë A4, lapsa me ngjyra.</p> 
<p>E Martë</p>	<p>Të ëmblat fruta: Qershia, manaferra, luleshtrydhja</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për frutin e qershisë, manaferrës, luleshtrydhes: forma/madhësia/ngjyra. Edukatorja shpjegon se me qershia, manaferra, luleshtrydhe mund të bëhet reçel, akullore dhe ëmbëlsira të ndryshme.</p> <p>Aktivitet: Fëmijët shikojnë si përgatitet një lëng frutash (fruti i ditës) në kuzhinë ose në grup nga kuzhinierja.</p> <p>Gjëegjëza : “Manaferra”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>



		Kënga: “Sa i dua frutat”	
E Mërkurë	<p>Akullorja</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja shpjegon: Akulloret janë me shije qershie, manaferre, luleshtrydhe dhe fruta të tjera. Akulloret janë me ngjyra të ndryshme. Ju pëlqen akullorja? Me çfarë shije ju pëlqen?</p> <p>Aktivitet 1. Improvizojmë përgatitjen e akullores Edukatorja bashkë me fëmijët improvizon përgatitjen e akullores me brum me ngjyra. Edukatorja vizaton akulloren në një fletë dhe u kërkon fëmijëve që të vendosin brumin tek pjesa e kupës.</p> <p>Aktiviteti 2. Lojë energjike “Akullore me pjata ose tullumbace” Edukatorja ngjit në mur një karton për të formuar kaushin e akullores. Sipër kartonit, vendos ngjitëse dhe i kërkon fëmijëve të ngjisin tullumbacet/pjatat, për të krijuar idenë e kupave. Edukatorja mund t’i kërkojë fëmijëve të numërojnë pjatat, emërtojnë akulloren dhe ngjyrat.</p> <p>Përrallë: “Ditëlindja e Justinës”</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: fletë A4, lapsa me ngjyra, ngjyra, miell, pjata, tullumbace. Libri “365 rrëfenja para gjumit” fq.105</p>
E Enjte	<p>Mjalti dhe bleta punëtore</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rreth bletës. Bleta është punëtore dhe shëtit nëpër lule. Nga bleta marrim mjaltin dhe me të bëjmë ëmbëlsira. Shoku më i mirë i mjaltit është Ariu.</p> <p>Punë dore: “Bleta” Fëmijët krijojnë bletën sipas ilustrimit në foto. Edukatorja nxit fëmijët të emërtojnë pjesët e trupit të bletës.</p> <p>Përrallë: “Llupësi i madh”</p> <p>Vjersha: “Bletës”</p>	<p>Manuali i Vjershave/Lojrave Mjete Didaktike Libri “365 rrëfenja para gjumit” fq.77</p>

<p>E Premte</p>	<p>Perimet e stinës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve mbi perimet e stinës së verës: domatja, kastravec, kungulli, patëllxhani etj.</p> <p>Aktiviteti: Përgatitja e supës me perime në kuzhinë e çerdhes.</p> <p>Punë dore me plastelinë: “Perimet e stinës” Edukatorja i orienton në njohjen e formave dhe ngjyrave (domatja e kuqe/e rrumbullakët).</p> <p>Loja: “Fruta dhe perimet, tabela e Lotos”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: tabela e lotos.</p>
-----------------------------------	---	---	---

Tema mujore: Njohja me karakteristikat e stinës së verës
Tema e javës III: Ngjyrat dhe numrat tek veshjet e fëmijëve në verë



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Veshjet tona shumëngjyrëshe në verë</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në verë vishemi më lehtë pasi është shumë nxehtë. Veshim : bluzë me mëngë të shkurtra, pantallona të shkurtra, funde, fustane, shapka, sandale, atlete, kapela, syze etj...</p> <p>Loja: “Veshja e kukullës”</p> <p>Përrallë: “Një modë e re”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike Libri “365 rrëfenja para gjumit” fq.86</p>
<p>E Martë</p>	<p>Përsërisim ngjyrat përmes veshjeve.</p>  <p>Dollapi im i veshjeve</p>	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se stina e verës ka shumë ngjyra, veshjet po ashtu në verë janë shumëngjyrëshe. Edukatorja ilustron ngjyrat duke i pyetur fëmijët për rrobat që kanë veshur..</p> <p>Aktivitet: Edukatorja së bashku me fëmijët sistemojnë dollapin. Edukatorja iu tregon fëmijëve se rrobat duhet të qëndrojnë në dollap, sirtarë etj.</p> <p>Vizatim/ngjyrosje: “Rrobat e mia shumëngjyrëshe të verës”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike Kapela, Syze Libra, revista</p>

<p>E Mërkurë</p>	<p>Kapelja Syzet e mia</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se, kur vjen vera vendosim në kokë kapele, shami të vogla dhe në sy syzet për t'u mbrojtur nga rrezet e diellit. Edukatorja pyet- Çfarë ngjyre i keni kapelet? Po syzet?</p> <p>Aktivitet: “Kapelja dhe syzet e mia”. Demonstrimi në grup i kapeleve dhe syzeve për fëmijë. (Edukatoret të bashkëpunojnë me prindërit për pajisjen e fëmijëve me kapele/syze.)</p> <p>Punë dore: “Kapelja dhe Syzet”- Fëmijët së bashku me edukatoret krijojnë kapele ose syze me letra/materiale të tjera me ngjyra.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: kartona, kashtë, fjongo, etj. Materiale të imëta</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Numërojmë veshjet dhe lodrat e plazhit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se kur vjen vera ne shkojmë në plazh, pishinë . Me vete marrim lodra: top, kovë, krahëza për notim, lopata me forma të ndryshme etj.</p> <p>Aktiviteti: Numërimi i lodrave të plazhit. rrobat e banjës, shapkat, kapelen, syzet</p> <p>Loja: “Treni”–improvizimi i udhëtimit me tren me fëmijët për në plazh.</p> <p>Vjersha: “Deti”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Krijimi i një moketi për stinën e verës</p> 	<p>Aktivitet : “Krijimi i një moketi për stinën e verës”- Fillimi i punës për krijimin e moketit që pasqyron stinën e verës. Edukatoret ndihmojnë fëmijët dhe e pasurojnë moketin gjatë javëve në vazhdim me elementë të ndryshëm të stinës.</p>	<p>Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: letra me ngjyra, lapsa, kartona, bukëpeshku, plastelinë, lodra.</p>

Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës

Tema e javës IV: Sa gëzim që erdhi Vera...! Format e argëtimit.




Java IV

Rubrika

Aktivitetet

Mjetet e Punës

<p>E Hënë</p>	<p>E diela ime në Cirk</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se kur vjen vera ne argëtohemi në këndin e lojërave, në teatrin e kukullave, në cirk, etj. A keni shkuar me prindërit ndonjëherë në cirk? Nëse po...A e njihni kllounin? Akrobatët?</p> <p>Punë dore: “Kllouni” Fëmijët nëpërmjet formave gjeometrike me letra me ngjyra ose plastelinë krijojnë kllounin.</p> <p>Loja: “Me topa letre” Improvizimi i rolit të prestigjatorit të cirkut.</p>	<p>Mjete Didaktike Libra, Revista</p>
<p>E Martë</p>	<p>Pasditja ime në këndin e lojrave</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve për këndet e lojërave në lagje, qytet. A keni shkuar tek këndet e lojrave? Çfarë lodre ju pëlqen më shumë, rrëshqitëset, shilarëset, etj.</p> <p>Loja energjike: “Zgjedhje e lirë”</p> <p>Vjersha: “Mos e këput lulen”</p> <p>Përralla: “Pinoku”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: lodra, kuba.</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Teatri me Kukulla</p>	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për teatrin e kukullave dhe si është i ndërtuar ai.</p> <p>Aktivitet: Improvizimi i një përralle në grup në formë teatri. Të përdoren kukullat e grupit.</p>	<p>Manuali i Lojërave Manuali i vjershave Mjete Didaktike</p>

		<p>Përralla: “Tre derrkucët”</p>	
<p>E Enjte</p>	<p>Piknik në kopshtin zoologjik</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për Kopshtin Zoologjik, pyet dhe nxit fëmijët të emërtojnë kafshët që njohin në kopshtin zoologjik: ariu, dhelpira, luani, majmuni, patat etj.</p> <p>Aktivitet: Improvizimi “Një ditë në kopshtin zoologjik”</p> <p>Punë dore: “Krijimi i kafshëve” përmes figurave gjeometrike.</p> <p>Përrallë: “Korbi dhe dhelpira”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Krijimi i një moketi për stinën e verës</p> 	<p>Aktivitet: “Krijimi i moketit për stinën e verës” Edukatorët ndihmojnë fëmijët ta pasurojnë moketin. (vazhdimi i punës)</p> <p>Lojë energjike</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>